DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-1671/13
Data Datum Date 15.03.2021

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Bekim Jashari,** Kryetar i Komunës së Skenderajt<br>**Fatbardha Haliti,** Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Goran Rakić,** Zëvendës Kryeministër dhe Minister i MPL-së<br>**Trim Berisha,** Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL | |
| Nga: | **Venera Çerkini,** Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 11.03.2021 Nr.0204-1671/12 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Skenderajt | |
| Lloji i aktit: | □ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim i Kuvendit të Komunës Nr. 01-463/01-0010978/21 për shfuqizimin e Vendimit Nr. 1-464-63509 të datës 05.12.2021, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme ndërtimore të Komunës së Skenderajt |
| I miratuar më datë: 26.02.2021 |
| I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 02.03.2021 |

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural <u>**është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**</u>.

Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-1671/13
-VI-
Data Datum Date 15.03.2021

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | **Bekim Jashari,** gradonačelnik opštine Srbica<br>**Fatbardha Haliti,** predsedavajuća Skupštine opštine Srbica | |
| Cc: | Jedinici za administraciju dokumenata u MLS-a<br>Jedinici za administarciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | **Goran Rakić,** zamenik premijera i ministar MLS-a<br>**Trim Berisha,** zamenik generalnog sekretara MLS-a, | |
| Od: | **Venera Çerkini,** rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MLS | Datum, 11.03.2021 br.0204-1671/12 |
| Službenik za utvrđivanje pravne procene:<br>Službenik-ca za izradu pravne procene: | **Xhevat Tafa,** rukovodilac Odseka za monitorisanje opština<br><br>**Vjosa Ahmetaj,** viša službenica za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta opštine Srbica | |
| Vrsta odluke: | Uredba Skupštine opštine | |

Uvaženi gradonačelniče,
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 06/2020 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MLS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka Skupštine opštine br. 01-463/01-0010978/21 o ukidanju Odluke br. 1-464-63509 od 05.12.2021.godine, o davanju na dugoročno korišćenje, na 99 godina nepokretne građevinske imovine opštine Srbica |
| Usvojena dana, 26.02.2021. godine, |
| Predložena za razmatranje u MLS dana, 02.03.2021. godine, |

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je **opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi.**

Ministarstvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

HYRESE-ULAZNA/INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data/Datum/Date: 02.03.2021
-VI- 0204-1671/12

01-463/01-0010948/21
Data: 02.03.2021

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assambly

Në bazë të nenit 11, 12 par.1. 2, shkronja d) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008), nenit 53 par.1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031, neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d) të Statuti të Komunës të Skenderajt nr.01-110-385, i datës:03.12.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullte të mbajtur me dt.26.02.2021 mori këtë:

## VENDIM

(Për Shfuqizimin e vendimit Nr.1-464-63509 të datës 05.12.2014, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për (99) vite të pronës së paluajtshme ndërtimore të Komunës së Skenderajt)

### Neni 1

**Miratohet** propozim-vendimi me nr.02-463/01-0008803/21, i dt.18.02.2021, Për Shfuqizimin e vendimit Nr.1-464-63509, të dt. 05.12.2014, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme ndërtimore të Komunës së Skenderajt.

### Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij vendimi behet shfuqizimi i vendimit Nr.1-464-63509 të datës 05.12.2014 të Kuvendit Komunal prona e paluajtshme ndërtimore e Komunës i është dhënë personit juridik NTSH Barnatorja "Ana" me pronar Drilon Malaj; njësia nr.1 në sipërfaqe prej 05.00 (pesë) ari parcela 588-1 sipas ofertës me Nr.2-464-47530 të datës 03.09.2014 për ndërtimin dhe rregullimin urban të bllokut Q3 (SHPI).

### Neni 3

Ky vendim bazohet në raportin e Kryetarit, nr.02-463/01-0008776/21 të datës 18.02.2021, mbi implementimin e kontratës Nr.2-464-1579 të datës 12.01.2015, duke ju referuar veprimeve të investitorit për mos përmbushje të kontratës nr.2-464-1579 të datës 12.01.2015.

### Neni 4

Më hyrjen në fuqi të këtij vendimi Shfuqizohet vendimit Nr.1-464-63509 të datës 05.12.2014.

**Neni 5**

**Këtij vendimi i bashkëngjitet:**
Raporti i Kryetarit, nr.02-463/01-0008776/21, të datës 18.02.2021.

**Neni 6**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës Drejtoria e Urbanizmit, Mbrojtje të Ambientit dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi.

**Neni 7**

Ky vendim hyn në fuqi, 15 dite pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit te tij ne ueb – faqen e komunës.

**Vendimi i Dërgohet :**
1x1 Zyrës së Kryetarit,
1x1 MPL-së,
1x1 DGJKP-së,
1x1 DUMA-së,
1x1 Arkivit,
1x1 Dosjes.

**Kryesuesja e KK-së**
**znj. Fatbardha Halit**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPSTINE
SKENDERAJ
Nr. 01-463/01-0010978/21
Data 02.03.2021

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assambly**

Në bazë të nenit 11, 12 par.1. 2, shkronja d) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008), nenit 53 par.1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031, neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d) të Statuti të Komunës të Skenderajt nr.01-110-385, i datës:03.12.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullte të mbajtur me dt.26.02.2021 mori këtë:

# VENDIM

(Për Shfuqizimin e vendimit Nr.1-464-63509 të datës 05.12.2014, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për (99) vite të pronës së paluajtshme ndërtimore të Komunës së Skenderajt)

**Neni 1**

**Miratohet** propozim-vendimi me nr.02-463/01-0008803/21, i dt.18.02.2021, Për Shfuqizimin e vendimit Nr.1-464-63509, të dt. 05.12.2014, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme ndërtimore të Komunës së Skenderajt.

**Neni 2**

Sipas nenit 1 të këtij vendimi behet shfuqizimi i vendimit Nr.1-464-63509 të datës 05.12.2014 të Kuvendit Komunal prona e paluajtshme ndërtimore e Komunës i është dhënë personit juridik NTSH Barnatorja "Ana" me pronar Drilon Malaj, njësia nr.1 në sipërfaqe prej 05,00 (pesë) ari parcela 588-1 sipas ofertës me Nr.2-464-47530 të datës 03.09.2014 për ndërtimin dhe rregullimin urban të bllokut Q3 (SHPI).

**Neni 3**

Ky vendim bazohet në raportin e Kryetarit, nr.02-463/01-0008776/21 të datës 18.02.2021, mbi implementimin e kontratës Nr.2-464-1579 të datës 12.01.2015, duke ju referuar veprimeve të investitorit për mos përmbushje të kontratës nr.2-464-1579 të datës 12.01.2015.

**Neni 4**

Më hyrjen në fuqi të këtij vendimi Shfuqizohet vendimit Nr.1-464-63509 të datës 05.12.2014.

**Neni 5**

**Këtij vendimi i bashkëngjitet:**
Raporti i Kryetarit, nr.02-463/01-0008776/21, të datës 18.02.2021.

**Neni 6**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës Drejtoria e Urbanizmit, Mbrojtje të Ambientit dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi.

**Neni 7**

Ky vendim hyn në fuqi, 15 dite pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit te protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit te tij ne ueb – faqen e komunës.

**Vendimi i Dërgohet :**
1x1 Zyrës së Kryetarit,
1x1 MPL-së,
1x1 DGJKP-së,
1x1 DUMA-së,
1x1 Arkivit,
1x1 Dosjes.

**Kryesuesja e KK-së;**
**znj. Fatbardha Haliti**

02-463/01-0008803/21
18-02-2021

Republika e Kosovës
Republic Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 27 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 50 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të dt.03.12.2008, Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë ______2021, Kryetari i Komunës i:

**PROPOZON**

I. Shfuqizimin e vendimit Nr.1-464-63509 të datës 05.12.2014 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme ndërtimore të Komunës së Skenderajt.

II. Sipas vendimit Nr. 1-464-63509 të datës 05.12.2014 të Kuvendit Komunal prona e paluajtshme ndërtimore e Komunës i është dhënë personit juridik NTSH Barnatorja "Ana" me pronar Drilon Malaj, njësia nr.1 në sipërfaqe prej 05,00 (pesë) ari parcela 588-1 sipas ofertës me Nr.2-464-47530 të datës 03.09.2014 për ndërtimin dhe rregullimin urban të bllokut Q3 (SHPI).

III. Ky propozim vendim bazohet në raportin e Kryetarit, nr. 02-463/01-0008776/21, të datës 18.02.2021, mbi implementimin e kontratës Nr.2-464-1579 të datës 12.01.2015, duke ju referuar veprimeve të investitorit për mos përmbushje të kontratës nr. 2-464-1579 të datës 12.01.2015.

IV. Ky propozim-vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal.

**Iu dërgohet:**
- Arkivit
- Kryesueses së KK-së

Kryetari i Komunës
Bekim Jashari

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr. 02-463/01-0008776/21
Data 18-02-2021

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skedneraj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 18.02.2021 |
| PËR/ZA/TO: | Komitetin për Politikë dhe Financa<br>Kuvendin e Komunës-, kryesuesen, znj. Fatbardha Haliti |
| NGA/ OD/FROM | Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Raport për mbikëqyrje të kontratës Nr. 2-464-1579 të datës 12.01.2015 e lidhur ndërmjet Komunës së Skenderajt dhe NTSH "Barnatorja "ANA" me pronar Drilon Malaj. |

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 22 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 27 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe sipas nenit 50 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008 paraqes këtë:

## RAPORT

Në bazë të vendimit të kuvendit të komunës nr.01-464-13 të datës 04.03.2013 komisioni vlerësues i kuvendit te komunës ka shpallë ankandin publik nr. 1-464-39008 të datës 21.07.2014 për dhëniën në shfrytëzim afatgjatë, 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, me koncesion tokën ndërtimore pronë e Komunës së Skenderajt, njësin nr.1 më sipërfaqe 05.00 (pesë) ari parcelen nr.588-1, për ndërtimin dhe rregullimin Urban te Bllokut Q3 (SHPI )- Hapësira përballë QKMF- së.

Komisioni vlerësues me rastin e hapjes së ofertave mban procesverbalin nr. 1-464-48177 të datës 04.09.2014 më të cilin vërtetohet së për njësinë nr.1 më sipërfaqe prej 05.00 (pesë) ari, parcelen nr.588-1, ofertues është personi juridik NTSH Barnatorja "ANA" në Skenderaj me pronar Drilon Malaj, sipas ofertes nr. 2-464-47530 te datës 03.09.2014, dhe se dokumentacioni i kërkuar nga ofertuesi është i kompletuar dhe oferta e tij fillestare dhe përfundimtare është 21% për m².

Pas shqyrtimit te ofertave komisioni vlerësues me datën 10.09.2014 i rekomandon kuvendit te komunës aprovimin e përzgjedhjes së ofertuesit, dhënien e pronës në

shfrytëzim për 99 vite, njesinë nr.1, në sipërfaqe 05.00 (pesë) ari, parcelen nr.588-1, personit juridik NTSH Barnatorja "ANA" nga Skenderaj me pronar Drilon Malaj.

Pas rekomandimit të komisionit vlerësues Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.11.2014 merr vendim nr.1-464-63509 të datës 05.12.2014 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, pronen e paluajtshme ndërtimore të komunës, njësin nr.1 në sipërfaqe prej 05.00 (pesë) ari, parcelen 588-1, personit juridik NTSH Barnatorja "ANA" me pronar Drilon Malaj.

Pas procedurave te lartcekura kryetari i komunës së Skenderajt dhe personi juridik NTSH Barnatorja "ANA" me pronar Drilon Malaj, lidhin kontratën nr. 2-464-1579 të datës 12.01.2015, dhe mbi bazën e kësaj dhe pas paraqitjes së kërkesës nga Drilon Malaj nr.6-351- 5002 të datës 28.01.2015, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit merr vendim nr. 6-351-5002 të datës 25.05.2015, për dhënien e lejes ndërtimore, pronarit Drilon Malaj për ndërtimin e objektit me etazhitet B+P+5+PH me dimensione 20,45m x 12,25 m, në njësin nr.1, parcela 588-1.

Kontrata nr.2-464-1579 e datës 12.01.2015 në nenin 3 { Obligimet e investitorit } parag.3.6 citon: investitori merr përsiper kompenzimin e hapësires banuese për banoret në objektet ekzistuese, përfshirë pagesën e qirasë deri në akomodim, e që investitori që nga ajo kohë e deri me tani nuk ka filluar ndërtimin e objektit sepse qysh në fillim ka hasur në pengesa nga banoret në objektet ekzistuese.

Poashtu më datën 29.02.2016 kuvendi i komunës ka marr vendim nr. 1-464-11702 të datës 03.03.2016 për ndarjen e hapësirës së banimit prej 70 m² për kryefamiljaren Sofije Radonçiç, që i është dhënë në kuadër të 21% të sipërfaqes së objektit, e që kjo është në kundërshtim më nenin 3 parag. 3.5 të kontratës nr. 2-464-1579 e datës 12.01.2015 , për arsye së investitorit i takojnë të gjitha obligimet për kompenzimin e hapësirës banuese për banorët në objektet ekzistuese përfshirë pagesën e qirasë deri në akomodim, ndërsa komuna nga 21% i sipërfaqes së objektit nuk ka asnjë obligim ndaj banorëve ekzistues në parcelën e dhënë në shfrytëzim investitorit Drilon Malaj, **dhe mbi bazën e kësaj kuvendi i komunës më datën 30.11.2020 merr vendim nr.1-463/01/01-005168/20 të datës 04.12.2020 për shfuqizimin e vendimit nr.1-464-11702 të datës 03.03.2016 që ishte në kundërshtim me kontratën e lartcekur.**

Pas shqyrtimit të tërë dokumentacionit të lartcekur, lidhur me çështjen në fjalë, dhe në bazë të raportit të drejtorisë për urbanizem dhe mbrojtje të ambientit të datës 19.11.2020 si dhe raportit të drejtorisë për gjeodezi kadastër dhe pronësi, nr. 05-052/01-0049741/20 të datës 20.11.2020, kryetari i komunës me datën 30.11.2020 i paraqet kuvendit të komunës raportin për mbikqyrje të kontratës në fjalë, duke rekomanduar që investitorit t'i vazhdohet leja e ndërtimit, sepse i njëjti ka bërë kërkesë më nr 01-0049121/20 të datës 16.11.2020 duke i'a bashkangjitur marrëveshjen gjyqësore nr. 431-0117048 të datës 04.06.2020 të cilën e ka lidhur me banorët ekzistues, në mënyrë që të filloj ndërtimin e objektit.

Në fund të krejt kësaj procedure, edhe përkundër përpjekjeve nga ana e komunës për zgjidhjen e kësaj çështje, lidhur me vazhdimin e lejes ndërtimore, investitori prap deklaron se nuk mund të filloj punimet, sepse neni 3 i kontratës nr.2-464-1579 të datës 12.01.2015 parag. 3.5 e obligon që ti ofrojë komunës 21% të sipërfaqes së objektit të vlerësuar në vlerë financiare sipas çmimores së rregullores komunale në fuqi, e që sipas investitorit kjo gjë është e papërballueshme për të realizuar ndërtimin e objektit.

Andaj duke ju referuar veprimeve të investitorit për mos përmbushje të kontratës nr. 2-464-1579 të datës 12.01.2015, obligohem që sipas nenit 22 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenit 27 të Rregullores Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendit të Komunës i rekomandoj **shfuqizimin e vendimit nr.1-464-63509 të datës 05.12.2014 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99-vite pronën e paluajtshme ndërtimore të komunës së Skenderajt.**

**Bashkangjitur këtij raporti:** Vendimi nr.464-13 i datës 04.03.2013, Ankandi Publik nr.1-464-39008 i datës 21.07.2014, Procesverbali nr.1-464-48177 i datës 04.09.2014, Rekomandimi nr.1-464-49971 i datës 10.09.2014, Vendimi nr.1-464-63509 i datës 05.12.2014, Kontrata nr. 2-464-1579 e datës 12.01.2015, Vendimi nr.6-351-5002 i datës 25.05.2015, vendim nr. 1-464-11702 të datës 03.03.2016, Kërkesa nr.01-0049121/20 e datës 16.11.2020, Marrëveshja gjyqësore nr.43-0117048 e datës 04.06.2020, Raporti i datës 19.11.2020, Raporti nr.05-052/01-0049741/20 i datës 20.11.2020, Raporti nr.02-052/01-0049764/20 i datës 20.11.2020, si dhe Vendimi nr.01-463/01-005168/20 i datës 04.12.2020.

**01Nr 464-13**
**Dt 04.03. 2013**

Me Propozimin e Kryetarit të Komunës së Skenderajt , me bashkëpunim më drejtorin për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit si dhe më drejtorinë për Gjeodezi Kadastër,dhe Pronë, Shqyrtimin dhe analizës se Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullativ të qytetit të Skenderajt të miratuar nga Kuvendi Komunal me datën 07.10.2011,01/Nr.350-73, në përputhje më orientimet e Strategjisë Zhvillimore 2013-2017 , të miratuar në Kuvend Komunal me datën 01.07.2011, 01/Nr.400/47,duke u bazuar në nenin 14.1,neni 17,pika a),b),c), neni 52.2 dhe neni 58 pika i) të Ligjit Nr.03/L-040 të LVL si dhe në përputhje më nenin 6dhe 7 të Ligjit Nr.04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës , neni 35 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008,Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur më datën **27.02.2013** mori ketë :

**V E N D I M**

**PËR DHËNIEN NË SHFRYETZIM AFATGJATË –NËNTËDHJETE NENTË (99) VITE NË FORMË KONCESIONI TË PRONAVE TE PALUJTSHME TË KOMUNËS .**

I Lokacioni: 03(031)-C-ISHP-0,6 ISD-3.
- Etazhiteti IV-VI ,-Destinimi afarizëm –banim,
-Parcela :558,
-Sipërfaqëja 0.20.00ha-(Hapësira përballë QKMF-së mbrapa Komunës)
II.Lokacioni :F-(F-11)ISHP -0,6 ISD-3
-Etazhiteti IV-VI,-Destinimi afarizëm –banim
-Parcela :550/1,549/0,
-Sipërfaqëja 0.78,94 ha-(Hapësira përballë Qendrës Zejtare)
III.Lokacioni :F2(F22,F23)-C-ISHP -06 ISD-3
-Etazhiteti IV-VI,-Destinimi afarizëm –banim
-Parcela :701-571,
-Sipërfaqja 0.72.64 ha –(Hapësira përballë Stacionit të Policisë)
IV.Për zbatimin këtij vendimi kompetent drejtoria për Gjeodozi Kadaster dhe Pronë,dhe drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Ambientit

**A r ë s y e t i m**

Duka marrë për bazë se pronat e paluajtshme komunale te lart cekua te cilat propozohen te jepën në shfrytëzim afatgjatë janë në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal dhe të përcaktuara me Planin Urbanistik të qytetit të Skenderajt, si hapësira ndërtimi,afarizëm-banim,e qe janë në harmoni me përcaktimet ligjore përkatësisht nenin 6. parag,pika1,2,3,4,5 të Ligjit Nr.04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
Gjithashtu duke vlerësuar interes publik implementimin e Planit Zhvillimor dhe Urban përmes investimeve private nga të cilat do krijonin të hyra buxhetore përmes një procesi konkurrues të hapur dhe transparent.
Mbështetur në dispozitat e lart shënuara u vendos si në dispozitiv të këtij -vendimi
**Vendimi hynë në fuqi ditën e miratimit në Kuvend te Komunës.**
**Vendimi u dërgohet: Arkivit, GJKP-se dhe dosjes**

**KRYESUESI I KK-se:**
**Ismet Salihu**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. / No. 1-464-39008
Data. / Dato 21.07.2014

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Nr.1-464-39008 Prot

Skenderaj, me 21.07.2014

## KOMUNA SKENDERAJ

Në kuadër të autorizimeve ligjore, përkatësisht; nenit 14. nenin 58, pika a),b),d),g),i) të Ligjit nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, në përputhje me nenin 6, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenet; 11,12,13,14,15,16,17,dhe 18 të Kapitullit III të Regullorës së QRK-së Nr.23/2013 për Percaktimin e Procedurave të Dhenies në Shfrytezim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, vendimeve të Kuvendit të Komunës; 01Nr.464-13. dt.04.03.2013 dhe 01Nr.1-464-35342, dt.04.07.2014, dhe Rekomandimit Nr.6-464-38957, dt 21.07.2014 të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit (DUMA), Komisioni Vlerësues bën këtë:

## SHPALLJE

**Për dhënjen në shfrytëzim afatë gjatë, nëntëdhjet e nëntë (99) vite me koncesion të tokës ndërtimore pronë e Komunës së Skenderajt me ankand publik**

## LËNDA E ANKANDIT PUBLIK

Lëndë e ankandit publik është toka e pandërtuar ndërtimore, pronë e Komunës së Skenderajt, e paraparë me Planin Zhvillimor Urban dhe Planin Rregullativ të qytetit të Skenderajt, miratuar nga Kuvendi i Komunës me Vendimin 01Nr. 350-73 të datës 07.10.2011, me dedikim për ndërtimin e objekteve me destinim afarizëm-banim,(sipas krietereve ndertuese të percaktuara nga DUMA), përqindjet e ndërtimit në interes të Komunës,kompenzimin e hapsirave banuese të banoreve ekzistues, depoziti për pjesëmarrje në ankand publik dhe koha e mbajtjes së ankandit publik.

1. ***Ndërtimi dhe Rregullimi Urban i Bllokut, Q3 {SHPI} – Hapësira përballë QKMF-së, mbrapa Komunës e ndarë në 4 njesi;***
   - ***Njesia 1,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1***
   - ***Njesia 2,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1***
   - ***Njesia 3,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1***
   - ***Njesia 4,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1***

2. ***Ndërtimi dhe Rregullimi Urban i Bllokut afarist dhe banesorë – Hapësira përballë parkut të qytetit***
   - ***Siperfaqe 360 (treqind e gjashtëdhjetë) m² (metra katëror)***

## TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Te drejtë për pjesëmarrje në ankand kanë:

- Personat fizik, shtetas te Republikës se Kosovës, shtetas të vendeve anëtare të Unionit Evropian dhe të OECD, si dhe shtetas të vendeve që nuk janë anëtarë të Unionit Evropian dhe të OECD-së, me kusht që në reciprocitet të theksojnë pronësinë e tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Kosovës,
- Personat juridik: person juridik i vendit, person juridik në pronësi të përzier dhe personi juridik i themeluar nga person i huaj fizik dhe juridik, të regjistruar në regjistrin përkatës te Republikës së Kosovës, persona juridik të huaj rezidentë të vendeve anëtare të Unionit Evropian dhe të OECD-së, me kusht që në reciprocitet të theksojnë pronësinë e tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Kosovë

## KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKAND PUBLIK

Personat e interesuar fizik dhe juridik dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik, (në formë të shkruar, për çdo njësi/ parcelë ndërtimore veç e veç, në të cilën theksohet për cilën parcelë ka të bëjë fletëparaqitja dhe cilat dokumente janë pjesë përbërëse e fletëparaqitjes, në zarf te posaçëm për secilën parcelë ndërtimore) të kompletuar me dëshmitë në vijim:

1. Fletëparaqitje nga dorëzuesi, në të cilën janë shkruar të dhëna për dorëzuesin e fletëparaqitjes, të dhëna për tokën ndërtimore për të cilën dedikohet fletëparaqitja dhe çfarë dokumentacioni dorëzohet si shtojcë;
2. Dëshmi për depozitë te paguar në origjinal (të theksohet numri i shpalljes dhe numri rendor i parcelës ndërtimore në qëllimin);

3. Për personat fizik certifikatë të nënshtetësisë
4. Për personat juridik dëshmi për regjistrim të personit juridik në regjistrin përkatës;
5. Garanci bankare prej rreth 10% të vlerës totale të projektit, për seriozitet të ofertës, me çka do të garantohet se do ta paguajnë të njëjtën në përputhje me çmimin e arritur për dhënjën në shfrytëzim të tokës ndërtimore në ankandin publik , garanci e cila do të jetë e vlefshme deri më 31.12.2016;
6. Deklaratë të nenshkruar nga dorëzuesi për kompenzimin e hapsirës banuse banoreve ekzistues perfshirë pagesen e qirase deri në akomodim.
7. Fotokopje të llogarisë personale transaktive.

Fletëparaqitjet që nuk janë të kompletuara me këto dëshmi, nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.
Dorëzuesit e fletëparaqitjeve është e nevojshme që të dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik, dhe fotokopje nga llogaria personale transaktive, në të cilën do të mund të kthehet depoziti për pjesëmarrje në ankandin publik.

## ÇMIMI FILLESTAR

Çmimi fillestar në ankandin publik për parcelat ndërtimore të sipërtheksuara është **21.00% (njëzet e një perqind)** e vlerës apo metër katror të ndërtimit ne interes të Komunës dhe kompenzimimi i hapsirës banuse banoreve ekzistues perfshirë pagesen e qirase deri në akomodim.

## DEPOZITI

1. Depoziti për pjesëmarrje ne ankandin publik është:

*(1)* Ndërtimi dhe Rregullimi Urban i Bllokut, Q3 – Hapësira përballë QKMF-së, mbrapa Komunës e ndarë në 4 njësi

- *Njesia 1,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1;* ***- 20.000.00 €,(njezet mijë euro)***
- *Njesia 2,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1;* ***- 20.000.00 €,(njezet mijë euro)***
- *Njesia 3,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1;* ***- 20.000.00 €,(njezet mijë euro)***
- *Njesia 4,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1;* ***- 20.000.00 €,(njezet mijë euro)***

(2).Ndërtimi dhe Rregullimi Urban i Bllokut afarist dhe banesorë – Hapësira përballë parkut të qytetit

- Siperfaqe 360 (treqind e gjashtëdhjetë) m² (metra katëror); ***- 20.000.00 €,(njezet mijë euro)***

2. Depoziti paguhet në një nga bankat e licencuara nga BQK, në Buxhetin e Komunës së Skenderajt, llogaria transaktive 1000650280000075, kodi 50417 – programi i urbanizmit me shenjen "depozitë për ankand publik për marrjen në shfrytëzim të tokës ndërtimore me koncesion" (të theksohet numri rendor i lokacionit me dedikimin e përcaktuar dhe numri i parcelës ndërtimore);

3. Depoziti ju kthehet në tërësi dorëzuesve te fletëparaqitjeve për ankandin publik në afat prej 15 ditësh, nga dita e mbajtjes së ankandit publik, përveç ofertuesve fitues depoziti i të cilëve do të llogaritet si pjesë e pagesës së ratës së parë 1/3, me rastin nënshkrimit të kontratës;

## AFATET

Ankandi publik është i hapur **45 (dyzet e pesë) ditë nga dita e shpalljes së Ankandit .**
Fletëparaqitjet për pjesëmarrje mund te dorëzohen në adresë të Komuna e Skenderajt, 41000, Rr." 18 Qershori ", pn. Skenderaj, apo drejtpërdrejt në arkivin e Komunës – objekti i administratës zyra nr.1.
Ankandi publik do të mbahet në sallën e mbledhjeve në objektin e Komunës së Skenderajt

Ankandi publik për: *(1)* Ndërtimi dhe Rregullimi Urban i Bllokut, Q3 – Hapësira përballë QKMF-së, mbrapa Komunës e ndarë në 4 njesi;
**do të filloje më 04.09.2014, e Enjte duke filluar nga ora 10.**
Njesia 1,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1; nga ora 10 deri 11
Njesia 2,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1; nga ora 11 deri 12
Njesia 3,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1; nga ora 12 deri 13
Njesia 4,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1; nga ora 13 deri 14

Ankandi publik për: (2).Ndërtimi dhe Rregullimi Urban i Bllokut afariste dhe banesor, Hapësira përballë parkut të qytetit

Siperfaqe 360 (treqind e gjashtëdhjetë) m² (metra katëror); nga ora 14 deri 15

## PROCEDURA

1. Ankandi publik mund të fillojë me së paku një pjesëmarrës në ankandin publik, për çdo parcelë ndërtimore veç e veç.
2. Ankandin publik e përcjell Komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës.
3. Ankandi publik fillon me shpalljen e çmimit fillestar të vlerës për metër katror, ndërsa realizohet me ankand publik nga pjesëmarrësit.
4. Ankandi kryhet "hap pas hapi" me rritjen e vlerës me çdo "hap" edhe atë jo më pak se **1.00 % (njëperqind)**
5. Ankandi publik llogaritet i mbyllur në momentin e kalimit të kohës së caktuar në shpallje, por nëse pas kalimit të dy minutave të fundit jepet ofertë nga pjesëmarrësit, atëherë afati i fundit për përfundim të ankandit publik vazhdohet edhe për dy minuta. Vazhdimi i afatit përfundimtar lejohet më së shumti tre herë gjatë ankandit publik.

6. Pjesëmarrësi në ankand publik që ka ofruar çmim më të lartë theksohet me statusin ofertues më i volitshëm.
7. Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përgatit procesverbal për ankandin publik të realizuar
8. Ofertuesi më i volitshëm është i detyruar që në afat kohor prej 30 ditë para nënshkrimit të kontratës <u>t'i paguajë **1/3 (një te treten)** e **mjeteve**, ndërsa pjesën e dytë brenda vitit të parë prej nënshkrimit të kontratës dhe pjesën e tretë vitin e dytë, në pajtim me çmimin përfundimtar të arritur në ankand.</u>
9. Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk i paguan mjetet në afatin e caktuar, atëherë do të llogaritet se toka ndërtimore nuk është dhënë në shfrytëzim, nuk do të nënshkruhet marrëveshje për dhënjën në shfrytëzim të pronës dhe mjetet e deponuara nuk do t'i kthehen ofertuesit më të volitshëm dhe ai nuk mund të marrë pjesë në çdo ankand të ardhshëm publik për parcelën ndërtimore në fjalë.
10. Kuvendi i Komunës merr vendim në bazë të rekomandimit të komisionit të vlerësimit, ndërsa Kryetari i Komunës nënshkruan marrëveshje me ofertuesin më të volitshëm për dhënjën në shfrytëzim për 99 vite të tokës ndërtimore në pronësi të Komunës së Skenderajt. Me marrëveshjen ofertuesi më i volitshëm (bleresi) detyrohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e nënshkrimit të të njëjtit, ta dorëzojë atë te noteri apo në gjykatë për solemnizim dhe në afat prej 2 muajve nga solemnizimi i kryer i marrëveshjes, të sigurojë leje për ndërtim të objektit të paraparë në përputhje me palnin urbanistik sipas të cilit toka është dhënë në shfrytëzim, në të kundërtën marrëveshja do të ndërpritet dhe pagesat nuk do t'i kthehen bleresit. Me marrëveshjen ofertuesi më i volitshëm detyrohet që ta ndërtojë objektin sipas planit urbanistik dhe kritereve te percaktuara nga DUMA sipas të cilit është dhën në shfrytëzim toka në <u>afat jo më të gjatë se 2 vjet nga dita e marrjes së lejes për ndërtim</u>, ku nëse objekti nuk ndërtohet në afatin e caktuar me fajin e bleresit, i njëjti do të ketë detyrim që të paguajë gjobë në vlerë prej 2% nga çmimi i përgjithshëm i arritur në ankandin publik për tokën në fjalë, për çdo muaj të kaluar.
11. Evidentimin dhe bartjen e të drejtave të shfrytëzimit të patundshmërive në librat e tokës dhe kadastrës i bartë Komuna.
12. Pjesëmarrësit e pakënaqur në ankandin publik mund të dorëzojnë kundërshtim te Komisioni për ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit publik . Pas kundërshtimit me aktvendim Komisioni është i detyruar që të vendosë në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Kjo shpallje do të publikohet në dy gjuhët zyrtare:
- ueb faqen zyrtare të Komunë së Skenderajt: www. Skenderaj-gov.net
- një gazetë të përditshme
- tabelën e shpalljeve publike të Komunës

Komisioni Vlersues ;
1. kryesues Bekë Hyleraj
2. Antar Cani Hajdari
3. Antar Xhevat ...
4. Antar Hakim ...
5. Antar Isuf Aliu
6. Antar Lulzim Kadriu
7. Antar Berat Dajaku

1

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS / ASSAMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr.
No. 1-464-48177

Data.
Dato 04.09.2014

KOMUNA SKENDERAJ

Për ankandin publik te shpallur me datën 21.07.2014 me nr. protokoli Nr. 1-464-39008 për dhënjen në shfrytëzim afatë gjatë, nëntëdhjet e nëntë (99) vite me koncesion të tokës ndërtimore pronë e Komunës së Skenderajt Komisioni Vlerësues me rastin e hapjes se ofertave me datën **04.09.2014** mban këtë:

# PROCESVERBAL

Ankandin publik e shpalli të hapur z. Bekë Hylenaj kryetar i komisionit për vleresim ku të pranishëm janë edhe anëtaret tjerë z. Gani Haliti, z.Hasan Shala, z.Berat Dajaku, z.Ismet Aliu dhe z. Lulzim Kadriu, ndersa në komison mungon z. Ylber Morina. Ankandi ështe hapur ne kohën e caktuar sipas shpalljes në ora 10.00 me hapjen e ofertave sipas njesive:

1. **Ndërtimi dhe Rregullimi Urban i Bllokut, Q3 {SHPI} – Hapësira përballë QKMF-së, mbrapa Komunës e ndarë në 4 njesi;**

*a) Njesia 1,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1*

Per kete njesi ofertuesi është personi juridik **NTSH Barnatorja "ANA" Skenderaj** me pronar z. Drilon Malaj, oferta mban numer protokoli 2-464-47530 te dates 03.09.2014.

| | Dokumentacioni i kerkuar | Posedon |
|---|---|---|
| 1 | Fletëparaqitje nga dorëzuesi, në të cilën janë shkruar të dhëna për dorëzuesin | Po |
| 2 | Dëshmi për depozitë te paguar në origjinal | Po |
| 3 | Për personat fizik certifikatë të nënshtetësisë | ska nevoj |
| 4 | Për personat juridik dëshmi për regjistrim të personit juridik | Po |
| 5 | Garanci bankare prej rreth 10% të vlerës totale të projektit, | Po |
| 6 | Deklaratë të nenshkruar nga dorëzuesi për kompenzimin e hapsirës banuse ban. | Po |
| 7 | Fotokopje të llogarisë personale transaktive. | po |

Dokumentacioni i kerkuar nga ofertuesi është i kompletuar dhe oferta e tij filestare dhe perfundimtare është **21 % per m²**. Për këtë njesi ofertues tjere nuk ka, për të cilen njesi mbyllet procedura ne ora 11.00.

LMU

*b) Njesia 2,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1*

Per kete njesi ofertuesi është **personi fizik Leonora Jakupi** , oferta mban numer protokoli 2-464-47689 te dates 04.09.2014.

| | **Dokumentacioni i kerkuar** | **Posedon** |
|---|---|---|
| 1 | Fletëparaqitje nga dorëzuesi, në të cilën janë shkruar të dhëna për dorëzuesin | Po |
| 2 | Dëshmi për depozitë te paguar në origjinal | Po |
| 3 | Për personat fizik certifikatë të nënshtetësisë | Po |
| 4 | Për personat juridik dëshmi për regjistrim të personit juridik | ska nevoj |
| 5 | Garanci bankare prej rreth 10% të vlerës totale të projektit, | Po |
| 6 | Deklaratë të nenshkruar nga dorëzuesi për kompenzimin e hapsirës banuse ban. | Po |
| 7 | Fotokopje të llogarisë personale transaktive. | po |

Dokumentacioni i kerkuar nga ofertuesi është i kompletuar dhe oferta e tij filestare dhe perfundimtare është **21 % per m²**. Për këtë njesi ofertues tjerë nuk ka, për të cilen njesi mbyllet procedura në ora 12.00.

*c) Njesia 3,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1*

Për ketë njesi ofertuesi është **personi fizik Leonora Jakupi** , oferta mban numer protokoli 2-464-47697 të datës 04.09.2014.

| | **Dokumentacioni i kerkuar** | **Posedon** |
|---|---|---|
| 1 | Fletëparaqitje nga dorëzuesi, në të cilën janë shkruar të dhëna për dorëzuesin | Po |
| 2 | Dëshmi për depozitë te paguar në origjinal | Po |
| 3 | Për personat fizik certifikatë të nënshtetësisë | Po |
| 4 | Për personat juridik dëshmi për regjistrim të personit juridik | ska nevoj |
| 5 | Garanci bankare prej rreth 10% të vlerës totale të projektit, | Po |
| 6 | Deklaratë të nenshkruar nga dorëzuesi për kompenzimin e hapsirës banuse ban. | Po |
| 7 | Fotokopje të llogarisë personale transaktive. | po |

Dokumentacioni i kerkuar nga ofertuesi është i kompletuar dhe oferta e tij filestare dhe perfundimtare është **21 % per m²**. Për këtë njesi ofertues tjere nuk ka, për të cilen njesi mbyllet procedura ne ora 13.00.

*d) Njesia 4,siperfaqe 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1*

Për këtë njesi ofertues nuk ka, respektohet procedura e mbylljes deri ne ora 14.00.

2. **Ndërtimi dhe Rregullimi Urban i Bllokut afarist dhe banesorë – Hapësira përballë parkut të qytetit siperfaqe 360 (treqind e gjashtëdhjetë) m² (metra katëror)**

Për ketë njesi ofertuesi është personi juridik **N.N. "RUKOLLI" Skenderaj**, oferta mban numer protokoli 2-464-47646 te datës 03.09.2014.

| | Dokumentacioni i kerkuar | Posedon |
|---|---|---|
| 1 | Fletëparaqitje nga dorëzuesi, në të cilën janë shkruar të dhëna për dorëzuesin | Po |
| 2 | Dëshmi për depozitë te paguar në origjinal | Po |
| 3 | Për personat fizik certifikatë të nënshtetësisë | ska nevoj |
| 4 | Për personat juridik dëshmi për regjistrim të personit juridik | Po |
| 5 | Garanci bankare prej rreth 10% të vlerës totale të projektit, | Po |
| 6 | Deklaratë të nenshkruar nga dorëzuesi për kompenzimin e hapsirës banuse ban. | Po |
| 7 | Fotokopje të llogarisë personale transaktive. | po |

Dokumentacioni i kerkuar nga ofertuesi është i kompletuar dhe oferta e tij filestare dhe perfundimtare është **21 %** per m². Për këtë njesi ofertues tjerë nuk ka, për të cilen njesi mbyllet procedura në ora 15.00.

Kryetari i komisionit shpall të mbyllur ankandin publik në ora 15,00 ne ditën e mbajtjes, dhe nënshkruan procesverbalin s'bashku me anetaret tjerë prezent.

Skenderaj 04.09.2014

Komisioni: kryetar z. Bekë Hylenaj ____________
anëtar z. Gani Haliti ____________
anëtar z. Hasan Shala ____________
anëtar z. Berat Dajaku ____________
anëtar z. Lulzim Kadriu ____________
anëtar z. Ismet Aliu ____________
anëtar z. Ylber Morina ____________

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Ne bazë te nenit 40 paragrafi 1 nën shenjen ( c ) te Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 35 paragrafi 1 nën shenjen ( c ) te Statutit te Komunës se Skenderajt nr.01-110-385 te datës 03.12.2008, nenit 9 alineja 1 te Ligjit për dhënie ne shfrytëzim dhe këmbim pronës se paluajtshme te komunës nr.04/L-144, nenit 15 alineja 3 te Rregullores QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave te dhënies ne shfrytëzim dhe këmbimit te pronës se paluajtshme te komunës. Komisioni Komunal Vlerësues pas hapjes publike te ofertave me dt.04.09.2014 sipas shpalljes se dhënies ne shfrytëzim afatgjatë për 99 vjet me koncesion te tokës ndërtimore pronë e Komunës se Skenderajt me ankand publik nr.1-464-39008 te dt.21.07.2011, bëri përzgjedhjen e ofertuesve duke përfillë te gjitha procedurat përkatëse mbi punën konform dispozitave përkatëse ligjore, gjë qe dëshmohet ne procesverbalin mbi punën e kryer nr.1-464-48177 te dt.04.09.2014, ndaj i propozon Kuvendit te Komunës se Skenderajt qe ne mbledhjen e mbajtur me datën__________2014 te miratojë këtë:

**REKOMANDIM**
**PËR SHPALLJEN E FITUESVE TE PËRZGJEDHUR NË DHËNIEN NE SHFRYTËZIM AFATGJATË TE PRONËS SE PALUAJTSHME TE KOMUNËS SE SKENDERAJT SIPAS ANKANDIT PUBLIK NR.1-464-39008 te dt.21.07.2014**

**Neni 1**

APROVOHET përzgjedhja e ofertuesve nga ana e Komisionit Komunal Vlerësues mbi dhënien ne shfrytëzim afatgjatë te pronës se paluajtshme te Komunës se Skenderajt me koncesion për 99 vjet sipas njësive te shpallura paraprakisht me ankand publik si ne vijim:

**1. Ndërtimi dhe Rregullimi Urban i Bllokut Q3 {SHPI}- Hapësira përballë QKMF-së, mbrapa Komunës e ndarë ne 4 njësi**

a) **Për njësinë 1, ne sipërfaqe prej 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1, ofertues është personi juridik NTSH Barnatorja "ANA" ne Skenderaj me pronar z.Drilon Malaj sipas numrit te protokollit te ofertës 2-464-47530 te dt.03.09.2014**
b) **Për njësinë 2, ne sipërfaqe prej 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1, ofertues është personi fizik Leonora Jakupi me nr.te protokollit te ofertës 2-464-47689 te dt.04.09.2014**
c) **Për njësinë 3, ne sipërfaqe prej 05.00 (pesë) ari, parcela 588-1, ofertues është Leonora Jakupi me nr.te protokollit te ofertës 2-464-47697 te dt.04.09.2014**

**2. Ndërtimi dhe Rregullimi Urban i Bllokut afarist dhe banesor – Hapësira përballë parkut te qytetit ne sipërfaqe prej 360 m² ( treqindegjashtëdhjetëmetrakatror) për këtë njësi ofertues është personi juridik** N.N."Rukolli" ne Skenderaj me nr. te protokollit te ofertës 2-464-47646 te dt.03.09.2014.

**Neni 2**

Obligohet Ekzekutivi për zbatimin e vendimit pas aprovimit te te njëjtit nga ana e KK.

**Neni 3**

Vendimi hyn ne fuqi ditën e miratimit.

Nr. 1-464-49971
Skenderaj, me 10.09 2014

Kryetari i Komisionit,
Bekë Hylenaj

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Kuvendi i Komunës Skenderaj**
Skupština Opštine Skenderaj
Municipal Assembly of Skenderaj

**01/Nr** 0-464-63569
**Dat** 05.12. **2014**

Në kuadër të procedurës se shqyrtimit administrativ,e sipas kërkesës se Ministrisë te Pushtetit Lokal Nr.02204-1475/3të datës 18.11.2014 për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit te Komunës Nr.01-464-57445 i datës 24.10.2014,e duke u bazuar me propozimin e Kryetarit të Komunës te mbështetur ne dispozitat nenit 11,58 dhe 82.2 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, si dhe neni 35 dhe 50.1 nën h) te Statutit te Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 te datës 03.12.2008,Kuvendi i komunës në mbledhjen e vet të mbajtur më datën **27.11.2014** mori këtë :

**V E N D I M**

**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PËR 99-VITE TË PRONËS SË PALUAJTSHME NDËRTIMORE TË KOMUNËS SË SKENDERAJT**

**Neni 1**

Drilon Malaj nga Skenderaj pronar i NTSH Barnatorja "ANA" i ipet në shfrytëzim afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë nëntë) vite prona e paluajtshme ndërtimore e komunës, njësia nr.1 në sipërfaqe prej 05,00(pesë) ari parcela 588-1 sipas ofertës me nr.të protokollit 2-464-47530 të datës 03.09.2014, për ndërtimin dhe rregullimin Urban te Bllokut Q3(SHPI)

**Neni 2**

Vendimi i dërgohet zyrës së kryetarit në procedim të mëtejmë.

**Neni 3**

**Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvend të Komunës**

**Vendimi u dërgohet :**
**- Arkivit**
**- Zyrës së Kryetarit të Komunës**
**- MAPL-së dhe**
**- Dosje –së**

**Kryesuesi i KK**
**Ismet Salihu**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 2-464-1579
No.

Data. 12-01-2015
Dato

1

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Skenderaj, 12 Janar 2015

Në bazë të kompetencave të percaktuara me nenin 14 e 17 dhe 58 pika d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 9 paragrafi 5 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, e në pajtim me nenin 18 paragrafi 6 dhe 7 të Rregullorës QRK Nr.23/2013 për Percaktimin e Procedurave të Dhënjes në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dt. 22.08.2013, duke vlersuar se janë permbushur të gjitha kriteret procedurale dhe ligjore; duke filluar nga Vendimi i Kuvendit Komunal 01Nr.464-13, dt.04.03.2013, për dhënjen në shfrytëzim afatgjatë nëntëdhjetë e nëntë vite të pronës së paluajtshme të Komunës, Shpalljen e ankandit publik Nr.1-464-39008, dt.21.07.2014 të nenshkruar nga Komisioni Vlerësues të publikuar në gazetën ditore, „Lajm" me 22.07.2014, web faqen zyrtare të Komunës si dhe në tabelen e shpalljeve, Procesverbalin mbi punën e komisionit gjatë shqyrtimit në ankandin publik, Nr.1-464-48177, dt.04.09.2014, Rekomandimin e Kryetarit të Komisionit Nr.1-464-49971, dt.10.09.2014, për Kuvendin e Komunës mbi shpalljen e fituesve të perzgjedhur në dhënjen në shfrytëzim afatëgjat të pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt sipas ankandit publik Nr. 1-464-39008, si dhe Vendimi i Kuvendit Komunal 01/Nr.1-464-63509,dt. 05.12.2014, me KONFIRMIMIN e ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr.0204-167117, dt.31.12.2014.
Andaj duke ushtruar pergjegjësitë në perputhje me autorizimet ligjore të lartë cekura, Kryetari i Komunës, lidhë këtë:

## KONTRATË

***Për Dhënjen në shfrytëzim afatëgjatë nëntëdhjetë e nentë (99) vite, pronën e paluajtshme ndertimore të Komunës me siperfaqe 05.00(pesë) ari , nr. i parcelës588-1 Zona kadastrale Skenderaj, njësia nr.1***

Palët nënshkruese në vijim:
**Komuna e Skenderajt**, e perfaq. nga Kryetari i Komunës, z. Sami Lushtaku ( në tekstin e më tejmë **„Komuna"**)

**NTSH.Barnatorja'ANA'** pronar Drilon Malaj, nr.let.1001748013,nr.i biz.70969629 me nr.fiskal 600988185
(në tekstin e më tejmë **„ investitori"**)

### Neni 1
*Qellimi*

Qellimi i kësaj kontratë është percaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve nenshkruese për ndertimin dhe rregullimin urban të pjesës së parë të bllokut Q3(SHPI) të paraparë sipas planit urban në siperfaqen prej 05.00(pesë) ari, pronë publike të dhënë në shfrytëzim afatëgjatë nga Komuna për Investitorin, sipas projektit detal që do ta hartoj investitori në kuadër të konditave teknike dhe urbanistike që do ti percaktoj Komuna.

### Neni 2
*Menyra e Financimit*

I tërë financimi dhe investimet për ndertimin dhe funksionalizimin e objektit afaristo- banesor do të bartën nga investitori me një plan dinamik jo më gjatë se dy vite nga dita e paisjes me lejen ndertimore.

**Neni 3**

*Obligimet e Investitorit*

3.1. Investitori obligohet të marrë përsipër hartimin e projektit detal të objektit dhe brenda 60 ditësh nga dita e nenshkrimit të kësaj kontrate të aplikojë për leje ndertimore.
3.2. Investitori obligohet të paguaj taksen e lejes ndertimore me 21% zbritje nga vlera totale e qmimit të pagesës.
3.3. Çdo tejkalim i afatit dy vjeqarë nga dita e marrjes së lejës ndertimore të ndertimit të objektit me fajin e investitorit, atëher investitori obligohet të paguaj gjobë më vler prej 2% nga qmimi i pergjithshëm prej 21% si fitues i ankandit, për cdo muaj të kaluar.
3.4. Me nenshkrimin e kësaj kontrate investitori pajtohet se nuk mund të kerkoj kthimin e mjeteve financiare te deponuara në llogari të Komunës sipas dedikimit për zhvillimin e këtijë projekti.
3.5. Investitori obligohet që ti ofrojë Komunës 21% të sipërfaqes së objektit të vlerësuar në vlerë financiare sipas qmimorës së rregullores komunale në fuqi, përfshirë edhe vleren e pjesmarrjes në ankand publik, për pronën e dhën në shfrytëzim afatgjatë.
3.6.Investitori merr përsiper kompenzimin e hapsirës banuese për banorët në objektet ekzistuese, përfshirë pagesen e qirasë deri në akomodim.
3.7.Investitori obligohet ti paguaj Komunës 1/3 (një të tretën ) ,**raten e parë** të vlerës financiare në kuader të 21% nga nenshkrimi i kontratës deri para marrjes së lejes ndertimore, **raten e dytë** brenda vitit të parë nga dita e marrjes së lejes ndertimore dhe **raten e tretë** brenda vitit të dytë dhe para pranimit teknik të objektit.
3.8.Investitori obligohet të caktoj një person kontaktues i cili do jetë në kontakt permanent me mbikqyrësin e Komunës për të implementuar obligimet që dalin nga kjo kontratë

**Neni 4**

*Obligimet e Komunës*

4.1.Komuna jep në shfrytëzim aftëgjatë nëntëdhjetë e nëntë (99) vite token Komunale ndertimore në ngastren 588-1, Zk Skenderaj me siperfaqe prej 05.00(pesë) ari, Njesia nr.1 e parapare për ndertimin e objektit Q3(SHPI). sipas planit urbanistik.
4.2.Komuna merr persiper që investitorit ti krijojë kushte sa me te mira teknike për t'i lehtesuar realizimin e projektit.
4.3. Komuna do caktoj një mbikqyrës i cili do ta përcjell realizmin e projektit dhe imlementimin e kësaj kontrate.
